



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/41
Datë: 13.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Projekt Kodi Penal i Republikës së Kosovës.
2. Projekt Kodi nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/41
Datë: 13.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 10/56 të datës 30 tetor 2015, në lidhje me Bordin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Prishtina, Sh.A Prishtinë

1. Ndryshohet dhe plotësohet nënpika 1.5. e Vendimit të Qeverisë nr. 10/56 të datës 30.10.2015, si në vijim:

1.5. Florim Dvorani.
2. Ky vendim paraqet pjesë përbërëse të vendimit nr. 10/56 datë 30.10.2015.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/41


Datë: 13.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, nr. prot. 1969-2, datë 12.04.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shpallja me interes të veçantë publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Kompleksit (Rezidencave) Qeveritar" Prishtinë, Zonat Kadastrale: Prishtinë, Zllatar, Matiqan, Hajvali, Çagllavicë, Komuna e Prishtinës dhe Zonat Kadastrale: Graçanicë dhe Badovc, Komuna e Graçanicës, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të zhvillojë procedurat e shpronësimit të pronave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Graçanicës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë